

DORACAK PËR VOTUESIT E RINJ



DORACAK PËR VOTUESIT E RINJ

Botimi i dytë i ndryshuar dhe i plotësuar.



Titulli: Doracak për votuesit e rinj

Autore dhe autore: Bojan Kordallov, Konsulent i pavarur, Admir Shabani, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Nina Shuloviç - Cvetkovska dhe Jasmina Todorovska-Miteva, Misioni i OSBE-së në Shkup

Redaktor: Elizabeta Postollovska, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Botues: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Misioni i OSBE-së në Shkup

Lektura: Bestel

Përkthimi në shqip: Bestel

Përpunimi, dizajni grafik dhe shtypi: Poliesterdej

Ilustrimet: Igor Stevkovski

Doracaku është punuar në kuadër të projektit „Mbështetje për qeverisje demokratike dhe proceset për përfshirje“ të Misionit të OSBE-së në Shkup, në vitin 2020, në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky është botimi i dytë i ndryshuar dhe i plotësuar në formë elektronike në Shtator 2021.



www.osce.org/skopje



Republika e Maqedonisë së Veriut
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

www.sec.mk

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe riprodhohet lirshëm për qëllime arsimore dhe qëllime të tjera jokomerciale, me kusht që Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Misioni i OSBE-së në Shkup të ceken si burime për çdo riprodhim të tillë.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Përmbajtja

Fjala hyrëse	4
Lista e shkurtesave të përdorura	5
1. Pjesëmarrja rinore	6
1.1. Përcaktimi dhe kuptimi i pjesëmarrjes.	7
1.2. Format e pjesëmarrjes rinore.	9
1.3. Pjesëmarrja politike e të rinjve.	10
2. Cilat zgjedhje ekzistojnë në vendin tonë?	12
2.1 Zgjedhjet parlamentare	14
2.2. Zgjedhjet presidenciale	16
2.3. Zgjedhjet lokale	17
2.4. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.	19
3. Përgatitja dhe realizimi i zgjedhjeve	20
3.1 Organet zgjedhore	21
3.1.1. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ).	22
3.1.2. Komisioni komunal i zgjedhjeve (KKZ).	23
3.1.3. Këshilli zgjedhor (KZ)	24
3.2. Faktorë të tjerë të rëndësishëm për përgatitjen dhe organizimin e zgjedhjeve	25
3.2.1. Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave të kandidatëve	25
3.2.2. Vëzhguesit	25
3.2.3. Mediat	27
4. Sot mbahen zgjedhjet - Votoj për herë të parë	28
4.1. Para se të votoni, duhet ta dini këtë	29
4.2. Procesi i votimit	31
5. E drejta e votës dhe mbrojtja	42
6. Përfshirja në procesin zgjedhor	42
6.1 Çfarë do të thotë përfshirje apo gjithëpërfshirje?.	43
6.2 Persona me aftësi të kufizuar	44
6.3. Pjesëmarrja e grave	45
7. Bëhu ndryshimi që dëshiron të shohësh	48
8. Pyetje dhe dilema që të rinjtë shpesh ia adresojnë KSHZ-së	50
Literatura e përdorur	62



FJALA HYRËSE

TË DASHUR VOTUES TË RINJ,

Secili prej nesh vazhdimisht fillon vazhdimisht kapituj të rinj dhe të rëndësishëm gjatë gjithë jetës. Nevoja për të pranuar ciklin e ndryshimeve dhe përshtatjen e vazhdueshme janë baza e funksionimit dhe suksesit të çdo personi. Nëse gjatë gjithë jetës sonë mbetemi të hapur për të kapërcyer sfida të reja dhe për të fituar njohuri dhe përvojë shtesë, mund të arrijmë shumë dhe të zhvillohemi vazhdimisht, duke u bërë persona të pjekur që hapërojnë fort në rrugën e tyre. Pjesëmarrja si një e drejtë themelore e qytetarëve është segment shumë i rëndësishëm në jetën tonë demokratike.

Pikërisht, viti i tetëmbëdhjetë në jetën e çdo personi është një pikë kthese e vërtetë. Atëherë çdo i ri fiton të drejtën të vendosë vetë për jetën e vet, por në të njëjtën kohë të jetë përgjegjës për veten dhe veprimet e veta. Në moshën 18 vjeç, secili prej nesh fiton të drejtën e votës. Zgjedhim deputetë dhe nëpërmjet tyre ndryshojmë ministrat dhe kryeministrat. E japim votën tonë për ndryshimet dhe trendet e ardhshme shoqërore. Zgjedhim se kush do të jenë kryetarët e komunave dhe këshilltarët tanë, zgjedhim se cili president ose presidente do të udhëheqë vendin tonë, por ata gjithashtu mund të na zgjedhin. Marrim pjesë në votimin në referendum në nivelin lokal dhe shtetëror, kështu shprehim pozicionin tonë personal për çështje të caktuara

të rëndësishme shoqërore dhe kështu ndikojmë tek autoritetet. Me pak fjalë, në ditën e zgjedhjeve, pushteti është plotësisht në duart tona. Secili prej nesh vendos individualisht për të ardhmen e vendit, zhvillimin lokal, ne zgjedhim se në çfarë lloj shoqërie do të jetojmë në vitet e ardhshme. Por, për të qenë në gjendje të bëni një zgjedhje sipas bindjeve tuaja personale dhe për të ushtruar të drejtën tuaj në mënyrë siç përshkruhet në Kodin Zgjedhor dhe ligjet, duhet të informoheni dhe të dini rrjedhën e procesit zgjedhor.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, si organi më i lartë në vend i ngarkuar për realizimin e zgjedhjeve, është i përkushtuar në drejtim të sigurimit votuesit e rinj të informohen mirë, në kohë për të drejtat e tyre për votim. Ky është qëllimi i këtij doracak. Në këtë doracak jemi përpjekur të përfshijmë dhe përgjigjemi në pyetjet themelore që lidhen me procesin zgjedhor, mënyrën e votimit dhe të drejtat që u përkasin votuesve.

Besojmë se doracak do të jetë shumë i dobishëm, ndërsa Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve do të jetë gjithmonë i hapur për pyetje, mendime, këshilla dhe propozimet tuaja inovative.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

BE Bashkimi Evropian

KKZ Komisioni Komunal i Zgjedhjeve

KSHZ Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

KZ Këshilli Zgjedhor

KZ Kodi zgjedhor

KZ-PDK Këshilla Zgjedhorë për kryerjen e votimit
në përfaqësitë diplomatike-konsullore
dhe zyrat konsullore të Republikës së
Maqedonisë së Veriut jashtë vendit

LNj Letërnjoftim

LV Lista e votuesve

NVAQ Numri i vetëm amë i qytetarit

OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim
të Evropës

PDK Përfaqësitë Diplommatike dhe Konsullore

VV Vendvotimi ose vendi i votimit

VZ Vendi zgjedhor



1. PJESËMARRJA RINORE

**“ASNJËHERË MOS DYSHONI SE
NJË GRUP I VOGËL NJERËZISH TË
ORGANIZUAR, LOJALË MUND TË
NDRYSHOJNË BOTËN; NË FAKT
KJO ËSHTË E VETMJA GJË QË KA
NDRYSHUAR BOTËN!”
- MARGARET MED**



Ndryshimi në shoqëri është i mundur vetëm nëse çdo individ merr pjesë në të.

Prandaj, të gjitha shoqëritë që kujdesen për zhvillimin dhe krijimin e ndryshimeve pozitive sociale duhet të mbështeten shumë tek të rinjtë. Me fjalë të tjera, të identifikojnë mundësitë dhe potencialin që kanë të rinjtë, të jenë bartës të ndryshimit dhe të përfshirë në të gjitha proceset që nënkuptojnë impuls pozitiv në çdo sferë të shoqërisë.

„Të rinjtë dinë dhe kanë kapacitetet të organizohen, komunikojnë, ndikojnë dhe veprojnë si forcë për transformim pozitiv.“¹

1.1. PËRCAKTIMI DHE KUPTIMI I PJESËMARRJES

Pjesëmarrja politike dhe qytetari aktiv janë elementët më të rëndësishëm të kulturës politike demokratike në çdo shoqëri. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme të motivohen të rinjtë për të marrë pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes, duke pasur parasysh që të rinjtë si grup shoqëror kanë kërkesa dhe nevoja specifike që duhet të merren parasysh në procesin e politikëbërjes.

Qytetarët aktivë, si dhe pjesëmarrja e qytetarëve, veçanërisht e të rinjve në jetën shoqërore është një nga përfitimet më themelore të demokracisë. Pjesëmarrja rinore nënkupton pjesëmarrjen aktive të të rinjve në bashkësitë lokale, aktivitete që lidhen me organizatat rinore², organizata për të rinjtë³, organizatat rinore ombrellë⁴, si dhe forumet rinore të partive politike, organizata nxënësish dhe studentësh dhe forma tjera të asociimit rinor të cilat i njeh Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, shoqatat e qytetarëve, pjesëmarrje në debate dhe ngjarje publike, përfshirje politike ose pjesëmarrje në këshillat lokale rinor.

Nëpërmjet pjesëmarrjes aktive, të rinjve u mundësohet të fitojnë dhe zhvillojnë aftësi të reja pavarësisht nga përkatësia etnike dhe gjinia e tyre, të ndërmarrin përgjegjësi për aktivitetet dhe vendimet e tyre, të japin sugjerime dhe ide për përmirësimin e

¹ Doracak për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Proceset Zgjedhore, 2017, Komisioni Evropian (KE) dhe UNDP : http://www.undp.org/content/dam/undp/library/Democratic%20Governance/Youth/2017%20-%20UNDP-EC%20-%20Youth%20Participation%20in%20Electoral%20Processes_Handbook%20fose%20EMBs.pdf

² Organizatë rinore është çdo organizatë e cila është regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione, në të cilën organi më i lartë vendimmarrës përbëhet nga të paktën dy të tretat e të rinjve të moshës 15 deri më 29 vjeç, dhe qëllimet dhe aktivitetet e të cilave përcaktohen dhe synojnë promovimin e interesave të të rinjve.

³ Organizata për të rinj është çdo organizatë e regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione, e cila nuk udhëhiqet nga të rinjtë ose është forum rinor i një partie politike, sektion rinor në sindikatë i organizuar si pjesë e një subjekti tjetër ligjor, dhe një pjesë e qëllimeve dhe aktiviteteve të saj programike synojnë promovimin e interesave të të rinjve.


⁴ Organizatat rinore ombrellë janë organizatat në të cilat anëtare janë format e ndryshme të organizimit rinor, të cilat bashkohen për realizimin e qëllimeve të përbashkëta në fusha specifike me interes për të rinjtë.

pozitës së tyre, si dhe të përfshihen në mënyrë aktive në aktivitetet në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Institucionet dhe organizatat ndërkombëtare kanë theksuar vazhdimisht rëndësinë e pjesëmarrjes rinore dhe përfshirjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes.

Të rinjtë⁵ në vendin tonë, janë të rëndësishëm njëjtë si të gjithë aktorët e tjerë të shoqërisë, për të gjitha proceset që kontribuojnë në zhvillimin dhe ndërtimin e shoqërisë demokratike, përkatësisht pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje dhe proceset e zbatimit në të gjitha nivelet dhe për të gjitha çështjet të cilat i tangojnë ata. **Kjo do të thotë se të rinjtë duhet të shprehin dhe të krijojnë mendime, të marrin pjesë dhe të kenë fuqinë për të marrë vendime për çështje dhe aspekte që janë në interes të tyre.**

Për herë të parë në vendin tonë, pjesëmarrja e të rinjve përcaktohet në Ligjin për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore⁶.



5 Në pajtim me Ligjin për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 14/20), të rinjtë e moshës 15-29 vjeç.

6 "Gazeta Zyrtare e RMV", nr.10/2020

1.2. FORMAT E PJESËMARRJES RINORE

Dallojmë dy dimensione të pjesëmarrjes rinore:

1 PJESËMARRJA E DREJTPËRDREJTË

nëpërmjet të cilës vendimet politike ndikohen drejtpërdrejt dhe e mundësojnë përfshirjen e të rinjve në strukturat vendimmarrëse në proceset politike dhe institucionale.

2 FORMA INDIREKTE

e pjesëmarrjes që synon të arrijë tek qytetarët dhe t'i inkurajojë ata të mbështesin çështje dhe pozicione të caktuara, nëpërmjet diskutimeve, ndërtimit të opinioneve dhe fushatave. Ekzistojnë mendime të ndryshme se si të ndahen format e pjesëmarrjes, por në përgjithësi mund t'i ndajmë në 3 kategori:

- ⇒ **pjesëmarrja konvencionale**
me pjesëmarrje në proces zgjedhor
- ⇒ **aktivizëm institucional**
përmes pjesëmarrjes në sektorin civil
- ⇒ **aktivizëm jashtë-institucional**
pjesëmarrje në grupe informale, protesta legale, etj.



1.3. PJESËMARRJA POLITIKE E TË RINJVE

Pjesëmarrja politike e të rinjve mund por nuk është e thënë të lidhet me anëtarësimin në parti politike. Pjesëmarrja politike e të rinjve është gjithashtu pjesëmarrja në proceset e vendimmarrjes. Të rinjtë mund të ndikojnë dhe kanë fuqinë për të ndikuar mbi këto procese dhe / ose të marrin pjesë si aktorë politikë në nivele të ndryshme, duke filluar nga ato lokale deri në rajonale, kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare. **Partitë politike nuk janë dhe nuk duhet të jenë zgjedhja e vetme për angazhim politik.** Por, të rinjtë kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet dhe mendimet e tyre mbi politikat që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme.

Pjesëmarrja e tyre politike mund të marrë forma të ndryshme, si për shembull aktivizmi rinor në fushën civile, praktikimi i qytetarisë aktive, ose kontributi në proceset që kanë të bëjnë me politikat dhe praktikat. Kjo mund t'i referohet pjesëmarrjes në këshillin lokal rinor, votimit në zgjedhje ose pjesëmarrje në procesin e përgatitjes së strategjisë për përfshirjen e grupeve të cenueshme dhe të ngjashme.

Zgjedhjet janë mënyra më e zakonshme konvencionale, përkatësisht formale e pjesëmarrjes politike. Rritja e daljes së votuesve të rinj dhe votueseve në zgjedhje, pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve është sfida e jashtëzakonshme, por gjithashtu mundësi për të rinjtë të marrin pjesë në jetën politike në mënyrë konvencionale. Kuvendi dhe këshillat e komunave paraqesin mundësi që të rinjtë të votojnë, por edhe të zgjidhen, pra të jenë në listat e kandidatëve për deputetë ose për këshilltarë në komunën në të cilën jetojnë. Pjesëmarrja e të rinjve si deputetë dhe deputete, kryetarë ose kryetare të komunave, përkatësisht këshilltarë dhe këshilltare në këshillat e komunave është shembull i shkëlqyeshëm i pjesëmarrjes politike të të rinjve.

Në dekadat e fundit, si në nivel nacional ashtu edhe në nivelin evropian, ka pasur një rënie të ndjeshme të pjesëmarrjes së votuesve të rinj në zgjedhjet. Kjo shihet si sfida e jashtëzakonshme, pasi të rinjtë shpesh preferojnë të marrin pjesë në forma dhe aktivitete të tjera.



Ka procese shoqërore dhe politike që kanë ndikim të madh tek të rinjtë në tjetërsimin e tyre nga pjesëmarrja politike konvencionale dhe qëndrim negativ ndaj politikës. Fatkeqësisht, të rinjtë gjithnjë e më shumë po tërhiqen, tregojnë apati dhe po shprehin mosbesim ndaj politikanëve. Programet e partive politike dhe fushatave nuk i njohin mjaft çështjet e të rinjve; të rinjtë nuk përfaqësohen ose politikanët nuk angazhohen dhe nuk ofrojnë zgjidhje për të rinjtë që rezultojnë me mosinteresim për të votuar. Apatia është pjesërisht e shkaktuar nga besimi se të rinjtë nuk kanë asnjë ndikim në proceset dhe vendimet politike dhe se ata shpesh shërbejnë vetëm si dekor

Praktika dhe përvoja ndërkombëtare tregon se të rinjtë mund dhe luajnë rol të madh në krijimin dhe ndryshimin e shoqërisë në të cilën jetojnë. Pikërisht kjo, është arsyeja pse përfshirja e tyre në proceset në të gjitha nivelet si qytetarë aktivë, të informuar dhe të përgjegjshëm është një nga mënyrat për një shoqëri demokratike më të mirë dhe të qëndrueshme. Të rinjtë me entuziazmin, fuqinë, potencialin e tyre gjithnjë e më shumë njihen si aktorë të rëndësishëm të ndryshimit kreativ dhe kjo është arsyeja pse zëri i të rinjve duhet të dëgjohet kur diskutohet dhe vendoset për çështje që i tangojnë ata. Të rinjtë duhet të kenë rol në mbajtjen e proceseve demokratike dhe shoqërive dhe ndikimin në ndërtimin e demokracisë, paqes dhe stabilitetit!



2. CILAT ZGJEDHJE EKZISTOJNË NË VENDIN TONË?

**ÇDO NDRYSHIM,
PËRKATËSISHT ÇDO
PËRMIRËSIM FILLON NË
MOMENTIN QË MARRIM
VENDIM PËR TË BËRË NJË
ZGJEDHJE.**

Ndërkaq, zgjedhje
bëjmë çdo ditë.

Për shembull, kur vendosim se cilin mësim do të fillojmë të mësojmë së pari, ku do të dalim për fundjavë, me kë duam të shoqërohemi, çfarë do të veshim për një rast të rëndësishëm, çfarë telefoni do të blejmë, cilin provim do të paraqesim të parin etj.

Prandaj, zgjedhja
më e rëndësishme

zgjedhja se në çfarë shoqërie duam të jetojmë, nëse idetë dhe zgjidhjet tona inovative do të dëgjohen dhe me çfarë ritmi do të ndodhin ndryshimet dhe përparimi për të cilin angazhohemi - e bëjmë atë ditën e zgjedhjeve.

E drejta e përgjithshme për votim përfshin dy komponentë: **të drejtën aktive dhe pasive për votim.**

E drejta aktive për votim është e drejta e qytetarit për të marrë pjesë drejtpërdrejt në zgjedhjen e përfaqësuesve të popullit. Për të ushtruar këtë të drejtë për votim, është e nevojshme që personi të regjistrohet në Listën zgjedhore dhe të ketë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme.

E drejta pasive për votim nënkupton të drejtën e qytetarit të kandidohet, përkatësisht të zgjidhet. Fakt i rëndësishëm që duhet të dihet është se Kushtetuta përcakton që person i cili është të paktën 40 vjeç mund të zgjidhet President i Republikës.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë:

- **ZGJEDHJE PARLAMENTARE;**
- **ZGJEDHJE PRESIDENCIALE;**
- **ZGJEDHJE LOKALE; DHE**
- **REFERENDUMI (NË NIVEL SHTETËROR DHE LOKAL).**

Të gjitha llojet e zgjedhjeve janë të **përgjithshme, të drejtpërdrejta, të lira dhe zhvillohen** me votim të fshehtë domethënë askush nuk e di dhe nuk duhet ta dijë për kë e jep votën tënde.

ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME

paraqesin votimin ose zgjedhjen e pushtetit në nivele të shumëfishta, në intervale kohore të përcaktuara saktësisht.

ZGJEDHJE TË DREJTPËRDREJTA

nënkupton mundësinë për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve politikë nga qytetarët dhe qytetaret.

ZGJEDHJE TË LIRA

do të thotë që çdo qytetar që ka të drejtë vote mund të shprehë lirisht mendimin e tij, përkatësisht pa ndonjë presion të vendosin për kë të votojnë.

VOTIM I FSHEHTË nënkupton që votuesi nuk duhet të zbulojë se për kë ka votuar dhe se askush nuk duhet ta thërrasë atë në përgjegjësi për votimin ose ta kërkojë nga ai / ajo të thotë se për kë ka votuar ose pse nuk ka votuar⁷.

7 Kodi Zgjedhor, neni 3 - E drejta e barabartë për votim, "Gazeta Zyrtare e RMV" 42/2020

(1) Presidenti i Republikës, deputetë, anëtarët e këshillave dhe kryetari i komunës zgjidhen në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira, me votim të fshehtë.

(2) Askush nuk mund ta thërrasë votuesin në përgjegjësi për votimin, as të kërkojë nga ai / ajo të thotë për kë ka votuar ose pse nuk ka votuar.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, një nga parimet themelore të demokracisë, pavarësisë dhe autonomisë është ndarja e pushtetit shtetëror në:

- ⇒ ligjvënës,
- ⇒ ekzekutiv dhe
- ⇒ gjyqësor.

Në këtë Doracak ne i referohemi pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, përkatësisht vetëm llojeve të zgjedhjeve që mbahen në vendin tonë dhe kohëzgjatjes së mandateve të funksionarëve të zgjedhur.


2.1 ZGJEDHJET PARLAMENTARE



KUVENDI është mbartës i pushtetit ligjvënës, përkatësisht i miraton ligjet në vend. Pikërisht për Kuvendin akoma thuhet se është dhomë përfaqësuese e çdo qytetari dhe qytetareje dhe deputetët dhe deputetet jo rastësisht quhen të zgjedhur të popullit. Qëllimi është që ata të vendosin të pavarur dhe sipas vullnetit dhe bindjes së tyre, gjatë kësaj duke u udhëhequr vetëm nga interesi i të gjithë qytetarëve dhe të ardhmes së vendit.

Sipas Kushtetutës sonë, Kuvendi përbëhet nga 120 deri 123 deputetë dhe deputete.

Në territorin e vendit tonë, aktualisht, janë përcaktuar gjithsej 6 njësi zgjedhore (NJZ), brenda të cilave zgjidhen nga 20 deputetë dhe deputete në secila. Me këtë numri i përgjithshëm i deputetëve të zgjedhur në Kuvend aktualisht është 120 deputetë.



Për realizimin e zgjedhjeve të deputetëve dhe deputeteve nga diaspora, Kodi Zgjedhor parashikon krijimin e 1 njësie zgjedhore plotësuese, përkatësisht njësinë zgjedhore 7, nga e cila zgjidhen maksimumi 3 deputetë ose deputete. Me këtë, numri i përgjithshëm i të zgjedhurve/ të zgjedhurave të popullit në Kuvend mund të arrijë maksimumi 123 deputetë.

Partitë politike dhe koalicionet marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare me listat me nga 20 kandidatë për deputetë dhe deputete në çdo njësi zgjedhore, përveç në NJZ 7 ku kandidojnë 3 deputetë dhe deputete. Në ditën e zgjedhjeve, sipas bindjes tonë personale, ne zgjedhim një nga listat e ofruara të kandidatëve në njësinë tonë zgjedhore.

Kjo nuk do të thotë që të 20 kandidatët nga lista zgjedhore e një opsioni politik do të zgjidhen në fund. Në varësi të numrit të përgjithshëm të votave të fituara në njësitë zgjedhore, sipas një formule të veçantë në fund të zgjedhjeve (formula e Dontit)⁸, llogaritet sa kandidatë zgjidhen nga secila listë zgjedhore. Për shembull, në një njësi zgjedhore mund të zgjidhen 10 deputetë/ deputete nga opsioni politik A, 7 deputetë / deputete nga opsioni politik B dhe 3 deputetë/ deputete nga opsioni politik C. Deputetët dhe deputetet zgjidhen për mandat prej 4 vjetësh dhe nuk mund të revokohen. Zgjedhja e deputetëve bëhet në një rreth zgjedhor.



8 Neni 127-a, "Gazeta Zyrtare e RMV" 42/2020

(4) Përcaktimi i rezultateve të zgjedhjeve bëhet duke zbatuar formulën e D'Hondt-it.

(5) Pas përcaktimit të numrit të përgjithshëm të votave të dhëna për atë numër të kandidatëve në njësi zgjedhore (e ashtuquajtura tabela zgjedhore), secila listë ndahet veçmas me serinë e pjesëtarëve 1, 2 dhe 3 derisa të gjitha vendet në njësinë zgjedhore të shpërndahen sipas parimit të përcaktuar në njësinë zgjedhore.

(6) Koeficientët nga ndarja e përmendur në paragrafin (5) të këtij neni rregullohen sipas madhësisë, me koeficientët më të mëdhenj për sa kohë që deputetët zgjidhen në njësi zgjedhore.

(7) Lista e kandidatëve merr aq vende saç ka koeficientët më të mëdhenj nga numri i koeficientëve të përmendur në paragrafin (b) të këtij neni.

2.2. ZGJEDHJET PRESIDENCIALE



Presidenti / presidentja përfaqëson Republikën dhe është Komandanti / Komandantja Suprem/e i/ e Forcave të Armatosura. Ai / ajo është pjesë e pushtetit ekzekutiv në vendin tonë. Presidenti/ presidentja zgjidhet për mandat prej 5 vjet, ndërsa për të qenë kandidat / kandidate ai / ajo duhet të jetë së paku 40 vjeç. Është e rëndësishme të përmendet se i njëjti person më së shumti dy herë mund të zgjidhet të ushtrojë funksionin president / presidente.

Në ditën e zgjedhjeve, ne zgjedhim president ose presidente nga radhët e kandidatëve të propozuar nga partitë politike dhe koalicionet ose nga kandidatët që garojnë si të pavarur nga cila do parti politike. Zgjedhja për president/ presidente ka mundësinë të zhvillohen në një ose dy rrethe zgjedhore.

Presidenti / presidentja i/e Republikës ka përgjegjësi të rëndësishme në politikën e jashtme, si dhe sigurinë, ndër të tjera, bën faljen e të burgosurve dhe ndan dekorime dhe mirënjohje për qytetarët, qytetare dhe organizata për meritat e tyre. Presidenti / presidentja gjithashtu ka fuqi të vendosë nëse do të nënshkruajë dekretet për shpalljen e ligjeve të miratuara nga Kuvendi.

2.3. ZGJEDHJET LOKALE

Me qëllim të rritjes së përfshirjes më të madhe dhe më të drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, çdo 4 vjet zgjedhim pushtetin lokal në komunën në të cilën jetojmë, përkatësisht në Qytetin e Shkupit. Në ditën e zgjedhjeve vendosim për zgjedhjen e kryetarit / kryetares së komunës dhe për listën e këshilltarëve/ këshilltareve në komunën tonë / Qytetin e Shkupit.

Këshilltarët dhe këshilltares zgjidhen për mandat prej 4 vjet dhe zgjedhja e tyre nuk mund të revokohet. Zgjedhja e këshilltarëve dhe këshilltareve bëhet në një, ndërsa zgjedhja e kryetarëve të komunave në një ose dy rrethe zgjedhore.

Pushteti lokal ka kompetenca të mëdha në sferën komunale, arsimin, planifikimin urban, kulturën, ekologjinë. Gjithashtu, emërimi i drejtorëve/drejtoreshave në shkollat fillore dhe të mesme varet nga pushteti lokal, ndërsa si rrjedhojë çfarë lloj sistemi arsimor do të ketë në komunën ku jetoni.

Kjo varet drejtpërdrejt nga fakti nëse dhe si do të votoni në zgjedhjet lokale, cilët persona do të jenë pjesë e pushtetit në komunën ku jetoni. Kjo tekstualisht do të thotë se në ditën e zgjedhjeve ju vendosni se si dëshironi të duket rruga juaj në katër vitet e ardhshme, sa shpesh do të pastrohet, rindërtohet, nëse do të ketë më shumë parqe dhe gjelbërim etj.

LLOJI I ZGJEDHJEVE:	ÇFARË ZGJEDHIM:	MANDAT / KOHËZGJATJA:	ÇFARË PUSHTETI ZGJEDHIM:
Zgjedhje parlamentare	Deputetë në Kuvend	4 vjet	Pushtet ligjvënës
Zgjedhje presidenciale	President i Republikës	5 vjet	Pushtet ekzekutiv
Zgjedhje lokale	Kryetarë të komunave në 80 komuna dhe Qyteti Shkup (gjithsej 81 njësi të vetëqeverisjes lokale) Këshilltarë ose anëtarët e këshillave të 80 komunave dhe Qytetit të Shkupit	4 vjet	Pushtet lokal
Referendum	Referendumi është formë e shprehjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendosjen për çështje të caktuara. Referendumi mund të shpallet për: 1) tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (referendum në nivel shtetëror); ose rajonin e komunës, qyteti Shkup dhe komunat në qytetin e Shkupit (referendum në nivelin lokal) ⁹ .	Shembull për referendum të mbajtur në nivel lokal: Referendumi në vitin 2017 që u mbajt në 6 komuna në pjesën juglindore të vendit kundër hapjes së minierave të arit dhe bakrit.	Shembuj të referendumi të nivelit shtetëror: 1) Referendumi në vitin 2018 në të cilin qytetarët kishin mundësi të prononcohen për pyetjen e referendumi lidhur me: „A jeni pro anëtarësimit në BE dhe NATO me pranimin e Marrëveshjes midis Republikës së Maqedonisë dhe Republikës Greqisë?“ 2) Referendumi në vitin 2004 për ruajtjen e ndarjes së mëparshme territoriale në vend, përkatësisht me qëllim abrogimin e Ligjit të ri për organizimin territorial

⁹ Ligji për Referendum dhe format tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 81/2005

2.4. QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

A mungon ndonjë në tabelën e mësipërme?

Po, është Qeveria ajo që është bartëse e pushtetit ekzekutiv në vendin tonë. Por, ministrat dhe Kryeministrin / kryeministren e Qeverisë nuk i votojmë drejtpërdrejtë në zgjedhje, por ata zgjidhen nga deputetët dhe deputetët e Kuvendit.

Me fjalë të tjera, duke dhënë votën tonë në zgjedhjet parlamentare, ne vendosim se cila parti politike ose koalicion do të drejtojë Qeverinë për mandat/ periudhë prej 4 vjet.

CILI ËSHTË EMRI I SAKTË I PERSONIT TË PARË TË QEVERISË?

Fjala „kryeministër“ (anglisht prime minister) do të thotë personi i parë i Qeverisë. Edhe pse fjala e ka zanafillën në Francën e shekullit 17-të, ky titull u shfaq për herë të parë në Britani të Madhe një shekull më vonë. Kushtetuta jonë përdor zyrtarisht termin „kryetar i Qeverisë“. Megjithatë, në të folurën e përditshme dhe në media, ne shpesh hasim në fjalën „premier“. Cilindo nga dy termat (Kryetar / kryetare e Qeverisë ose Premier / Premiere) të përdorim, nuk do të gabojmë. Por është e rëndësishme të mbajmë mend se shprehja „Premier / premiere i/e Qeverisë“ është e pasaktë.



3. PËRGATITJA DHE REALIZIMI I ZGJEDHJEVE



3.1 ORGANET ZGJEDHORE


Shpesh herë, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të haset formulimi si vijon: “Administrimi i zgjedhjeve është në kompetencë të organeve zgjedhore.” Organet zgjedhore kujdesen për rendin dhe fshehtësinë e zgjedhjeve, ashtu siç është përcaktuar me ligjet. Administrata zgjedhore është gjithashtu përgjegjëse për zhvillimin në kohë të zgjedhjeve, si dhe për koordinimin dhe mbështetjen e të gjithë procesit zgjedhor nga shpallja deri në numërimin e votave, përkatësisht shpalljen e rezultateve përfundimtare.

Kush i përbën organet zgjedhore, përkatësisht organet për realizimin e zgjedhjeve?

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (**KSHZ**)

Komisionet komunale zgjedhore (**KKZ**) dhe Komisioni zgjedhor i Qytetit Shkup

Këshillat zgjedhorë (**KZ**) Këshilli zgjedhor për kryerjen e votimit jashtë vendit



3.1.1. KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE (KSHZ)

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për ligjshmërinë në përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve dhe mbikëqyr punën e organeve zgjedhore. Ai përbëhet nga kryetar / kryetare, nënkryetar dhe anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, me propozim paraprak të partive politike.

Disa nga aktivitetet kryesore që i kryen KSHZ:

- ⇒ kujdeset për organizimin dhe zhvillimin e plotë të zgjedhjeve;
- ⇒ miraton akte nënligjore;
- ⇒ emërton përbërjen e KKZ / KZ të Qytetit Shkup;
- ⇒ konfirmon dhe shpall listat e kandidatëve për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, ndërsa për zgjedhjet lokale këtë e bën KKZ;
- ⇒ siguron trajnim për anëtarët e organeve zgjedhore në dy nivelet e tjera (KKZ dhe KZ);
- ⇒ informon dhe edukon publikun, përkatësisht votuesit për mënyrën e votimit dhe ushtrimin e së drejtës së votës;
- ⇒ raporton për jehonën në ditën e zgjedhjeve;
- ⇒ shpall rezultatet e para dhe rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të zhvilluara (për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, ndërsa për zgjedhjet lokale bëhet nga KSHZ)
- ⇒ vendos për kundërshtimet
- ⇒ plotëson dhe paraqet të dhëna statistikore për nevojat e Entit Shtetëror të Statistikave.

Për më tepër, të gjitha organet zgjedhore, dhe posaçërisht KSHZ-ja, kujdesen veçanërisht për të motivuar të rinjtë dhe për të forcuar pjesëmarrjen e të rinjve në procesin zgjedhor.

3.1.2. KOMISIONI KOMUNAL I ZGJEDHJEVE (KKZ)

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve kujdeset për ligjshmërinë në përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve përmes emërimit dhe mbikëqyrjes së punës mbi këshillat zgjedhore. Komisionet Komunale të Zgjedhjeve përbëhen nga kryetar dhe 4 anëtarë që kanë zëvendësit e tyre. Ata zgjidhen nga të punësuarit në administratën shtetërore dhe komunale dhe administratën e Qytetit të Shkupit sipas zgjedhjes së rastësishme, për një periudhë pesë vjeçare. Emërimi i tyre bëhet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Komisionet Komunale të Zgjedhjeve janë të vendosura në komuna dhe janë përgjegjëse për kryerjen e aktiviteteve zgjedhore në njësitë zgjedhore dhe qendrat e votimit.

Ka aq komisione komunale zgjedhore sa ka njësi të vetëqeverisjes lokale në vend (80 komuna dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, që do të thotë 81)

Disa nga aktivitetet kryesore të kryera nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve:

- ⇒ emëron përbërjen e këshillave zgjedhore;
- ⇒ informon qytetarët për qendrën e votimit;
- ⇒ pas zgjedhjeve, përmbledh rezultatet në nivelin e tërë komunës;
- ⇒ vendos për ankesat për votim personal fillimisht vetëm gjatë votimit
- ⇒ konfirmon dhe shpall listat e kandidatëve për zgjedhjet lokale, ndërsa për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare bëhet nga KSHZ
- ⇒ shpall rezultatet fillestare dhe rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të zhvilluara (për zgjedhjet lokale, ndërsa për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare bëhet nga KSHZ)

Vetëm mbi këtë bazë, përkatësisht si anëtarë të KKZ-ve/ KZ të Qytetit Shkup, rreth 1.000 persona angazhohen gjatë zgjedhjeve. Është e rëndësishme të theksohet edhe një herë që çdo pjesëmarrës në procesin zgjedhor ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e zgjedhjeve të rregullta, të lira dhe të ndershme.

3.1.3. KËSHILLI ZGJEDHOR (KZ)

Këshilli zgjedhor formohet veçmas në secilin vendvotim. Këshilli zgjedhor përbëhet nga 10 anëtarë, dhe: një kryetar/e, një nënkryetar/e, katër anëtarë/e dhe katër zëvendësit e tyre. Kryetari /ja dhe dy anëtarë/et, si dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga të punësuarit në administratën shtetërore, publike, komunale dhe administratën e Qytetit Shkup në mënyrë të rastësishme, për një periudhë prej katër vjetësh.

Në secilin këshill zgjedhor, 2 anëtarë/e dhe zëvendësit e tyre emërohen me propozim të partive politike nga pushteti dhe 2 anëtarë/e dhe zëvendësit e tyre emërohen me propozim të partive politike nga opozita.

Disa nga aktivitetet kryesore që i kryen KZ:

- ⇒ realizon votimin në vetë qendrën e votimit (përshkruar në detaje në kapitullin tjetër të këtij doracaku)
- ⇒ parashikon votim të fshehtë dhe falas
- ⇒ përcakton dhe përmbledh rezultatet nga votimi në qendrën e votimit në Procesverbalin për votim, duke përmbledhur dhe përcaktuar rezultatet nga qendra e votimit (Formulari nr. 16);

KËSHILLAT ZGJEDHORE PËR VOTIM JASHTË VENDIT KRYEJNË TË NJËJTAT DETYRA SI KËSHILLAT ZGJEDHORË NË VEND, NDËRSA VOTIMI ZHVILLOHET NË AMBASADAT, PËRKATËSISHT PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE-KONSULLORE (PDK) TË VENDIT TONË JASHTË VENDIT.

KA POTHUAJSE 3.500 QENDRA VOTIMI NË TË GJITHË VENDIN KU VOTUESIT USHTROJNË TË DREJTËN E TYRE PËR TË VOTUAR. NËSE MARRIM PARASYSH SE NË DITËN E ZGJEDHJEVE, 10 ANËTARË ANGAZHohen NË SECILIN VEND TË VOTIMIT, KEMI NUMËR TOTAL PREJ 35.000 PERSONASH TË CILËT JANË TË ANGAZHUAR NË KËSHILLAT ZGJEDHORE DITËN E ZGJEDHJEVE.

3.2. FAKTORË TË TJERË TË RËNDËSISHËM PËR PËRGATITJEN DHE ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE

3.2.1. PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PARAQITËSVE TË LISTAVE TË KANDIDATËVE

Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave të kandidatëve kanë të drejtë të jenë të pranishëm në qendrat e votimit dhe të monitorojnë të gjithë procesin zgjedhor deri në përcaktimin dhe shpalljen e rezultateve.

Përfaqësuesi/përfaqësuesja i/e paraqitësit të listës në mbledhjen e organeve zgjedhore mund të paralajmërojë për parregullsi në punën e tyre dhe mund të kërkojë që parregullsia, me një përshkrim specifik të ngjarjes, të futet në Procesverbal për votim, përmbledhje dhe përcaktim të rezultateve nga vendvotimi (Formulari numër 16).

Përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave kanë të drejtë të kërkojnë dhe kryejnë inspektim të plotë të të gjithë dokumentacionit të organit zgjedhor.

3.2.2. VËZHguesIT

Vëzhguesit e akredituar monitorojnë ligjshmërinë e punës së KZ-së dhe të gjithë operacionin zgjedhor, përkatësisht nëse procesi zgjedhor zhvillohet në atmosferë paqësore, të drejtë dhe demokratike, respektimin e të drejtave të votimit, por edhe të drejtat e njeriut në përgjithësi, dhe të ngjashme. Akreditimet lëshohen nga KSHZ-ja me kërkesë paraprake. Prania e tyre mund të tregojë dhe parandalojë parregullsitë zgjedhore dhe mosrespektimin e ligjeve zgjedhore. Vëzhguesit nuk mund të ndërhyjnë drejtpërdrejt në punën e organeve zgjedhore, por prania e tyre është një lloj garancie për rregullsinë e zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë, vëzhguesit kanë të drejtë të shënojnë vërejtje dhe parregullsi të mundshme, si dhe të informojnë publikun dhe mediat për pikëpamjet e tyre mbi rrjedhën dhe zbatimin e të gjithë procesit zgjedhor.

Vëzhguesit mund të vëzhgojnë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe janë të detyruar të respektojnë Kodin Zgjedhor, kodin e vëzhgimit dhe të identifikohen siç duhet me ndihmën e distinktivit të lëshuar nga KSHZ-ja.

Për qëllime të monitorimit të zgjedhjeve, me ftesë të autoriteteve shtetërore, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE / ODIHR) në vendin tonë mund të hapë



misionin vëzhgues të OSBE / ODIHR për çdo zgjedhje. Misioni drejtohet gjithmonë nga një ekip kryesor i vendosur në Shkup, vëzhgues afatgjatë të vendosur në të gjithë vendin, si dhe nëse është e nevojshme misioni i OSBE/ODIHR mund të kërkojë nga vendet e tij anëtare që të dërgojnë një numër të caktuar të vëzhguesve afatshkurtër.

Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit e OSBE/ODIHR monitorojnë vendet e votimit, votimin, numërimin e votave dhe përmbledhjen e rezultateve.

Misioni publikon raport periodik gjatë punës së tij. Një ditë pas zgjedhjeve, publikohet deklaratë mbi gjetjet fillestare dhe konkluzionet e zgjedhjeve të kryera, dhe disa javë më vonë raport përfundimtar mbi vëzhgimin nga MVZ i OSBE/ODIHR.

Brenda tërë procesit të realizimit të zgjedhjeve, misioni vëzhgues i Bashkimit Evropian (BE), si dhe disa përfaqësues të misioneve diplomatike dhe konsullore në vendin tonë janë gjithashtu vëzhgues.

OSHC-të (vendore ose ndërkombëtare) misioni kryesor i të cilave është të përmirësojë të drejtat e njeriut dhe avancimin e proceseve demokratike dhe zgjedhore mund të marrin pjesë si vëzhgues të pavarur në zgjedhjet dhe kështu të forcojnë transparencën e procesit të përgjithshëm.

Gjatë fushatës zgjedhore, ata mund të monitorojnë dhe ofrojnë këqyrje në transparencën e financimit të fushatës, si dhe të raportojnë publikisht për të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës të bëra nga partitë politike.

Për më tepër, OSHC-të mund të kryejnë programe edukative për votuesit, në bashkëpunim me autoritetet kompetente ose organet ndërkombëtare dhe të ndihmojnë në shpërndarjen e informacioneve zgjedhore.

„Pavarësisht nga procesi zgjedhor, ata mund të llojnë në mënyrë të pavarur të politikë bërësit dhe administratorët e procesit zgjedhor për të mbështetur politika më të mira zgjedhore dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive individuale, ose për rregullim më efektiv të zgjedhjeve në drejtim të financimit të fushatës.”¹⁰

10 ACE Project, Electoral Knowledge Network: <http://aceproject.org/ace-en/topics/ei/eie/eie03/eie03c/eie03c01?>

3.2.3. MEDIAT

Gazetarët vendas dhe të huaj kanë të drejtë të ndjekin procesin zgjedhor pa pengesa. Të gjithë gazetarët e akredituar nga shoqatat profesionale të mediave raportojnë për zgjedhjet në qendrat e votimit, dhe gjithmonë duhet të kenë identifikimin e duhur me ta.

Është detyrë e organeve zgjedhore të bashkëpunojnë me mediat sepse ato përfaqësojnë interesin publik, përkatësisht ato kontribuojnë drejtpërdrejt në informimin në kohë dhe të besueshëm të qytetarëve për të gjithë procesin zgjedhor.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vazhdimisht investon në përmirësimin e komunikimit me mediat vendase dhe të huaja gjatë gjithë procesit të realizimit të zgjedhjeve, dhe veçanërisht ditën e mbajtjes së tyre, deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare për të gjitha zgjedhjet.





4.

**SOT MBAHEN
ZGJEDHJET
- VOTOJ PËR
HERË TË PARË**



4.1. PARA SE TË VOTONI, DUHET TA DINI KËTË

Për të ushtruar të drejtën tuaj për të votuar, duhet të regjistroheshi në Listën e votuesve.

Në Listën e votuesve regjistrohen të gjithë shtetasit mbi 18 vjeç përfshirë ditën e votimit (për rrethin e parë dhe të dytë) të cilët kanë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe që kanë dokument adekuar për identifikim personal.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kryen regjistrimin, plotësimin dhe fshirjen në Listën e votuesve sipas detyrës zyrtare në bazë të të dhënave nga librat amë, evidencën e vendbanimit dhe shtetësisë, dhe sipas të dhënave të tjera zyrtare, si dhe me verifikimin e drejtpërdrejtë.


Për të siguruar që të gjithë mund të ushtrorjnë të drejtën e tyre ligjore për të votuar, KSHZ-ja kryen këqyrje publike të Listës së votuesve para çdo zgjedhjeje ose referendumi.

Çdo qytetar mund të kontrollojë Listën e Votuesve në zyrat rajonale të KSHZ-së, por edhe përmes aplikimit në ueb-faqen të disponueshme në <https://izbirackispisok.gov.mk>

Nëse nuk jeni regjistruar, ndërsa keni letërnjoftim të vlefshëm, mund të paraqisni kërkesë për regjistrim në zyrën rajonale të KSHZ-së, ose në mënyrë elektronike direkt në KSHZ.



Gjithashtu, duke inspektuar të dhënat nga Lista e votuesve, mund të kontrolloni numrin e qendrës së votimit dhe adresën e objektit ku mund të ushtroni të drejtën tuaj të votës.



Ju votoni në qendrën e votimit në komunën tuaj, të përcaktuar sipas vendbanimit në çdo kohë ndërmjet orës 7:00 dhe 19:00.¹¹

¹¹ Sipas rekomandimeve dhe udhëzimeve të Komisionit për Parandalimin e Sëmundjeve Infektive dhe për shmangien e turmave, si dhe mbrojtjen e qytetarëve të Covid-19, votimi në Zgjedhjet Parlamentare 2020 ishte planifikuar të zhvillohej midis orës 7:00 dhe 21:00

Detyrimisht me vete duhet të keni dokument identiteti: letërnjoftim ose pasaportë.

E RËNDËSISHME:

Në qoftë se nuk keni pasaportë ose letërnjoftim, nuk do të lejoheni të votoni. Ky ndalim ekziston në mënyrë që të mbrojë të drejtën tuaj ose të dikujt tjetër për të votuar nga abuzimi ose prezantimi i rrejshëm në emër të dikujt tjetër.

Dokumentet e tjera si patentë shoferi, karta bankare, indeks dhe ngjashëm nuk konsiderohen dokumente identifikimi personal dhe nuk do të mund të ushtroni të drejtën e votës.

Secili votues ose votues/e voton vetëm një herë. Nuk lejohet aq që është e mundur të ktheheni gjatë ditës dhe të votoni përsëri, pasi të keni ushtruar tashmë të drejtën tuaj për të votuar. Kjo do të thotë:

NJE VOTUES = NJE VOTË!

4.2. PROCESI I VOTIMIT

Procesi i votimit zhvillohet EKSKLUZIVISHT SIPAS RADHITJES MË POSHTË:

1. Kontrolli i dokumenteve për identifikim personal,
2. Identifikimi biometrik i votuesit,
3. Kontrolli dhe nënshkrim i çertifikatave nga Lista Zgjedhore,
4. Lëshimi i fletës së votimit,
5. Dhënia e fletëvotimeve, dhe
6. Votomi pas paravanëve të votimit.

HAPI

1

KONTROLLI I DOKUMENTEVE PËR IDENTIFIKIM PERSONAL

Pasi që të kesh hyrë në vendin zgjedhor një nga anëtarët e Këshillit Zgjedhor që kontrollojnë dokumentet për identifikim personal do të kërkojë ta tregosh dokumentin për identifikim personal.

Anëtari i Këshillit Zgjedhor verifikon identitetin e zgjedhësve në bazë të dokumenteve të tyre për identifikim personal.

Në këtë kontekst, zgjedhësit mund ta vërtetojnë identitetin e tyre personal **VETËM ME** një nga dy dokumentet në vijim të lëshuara nga organi kompetent i Republikës së Maqedonisë së Veriut:

- 1) **LETËRNJOFTIM TË VLEFSHËM**, ose
- 2) **DOKUMENT TË VLEFSHËM UDHËTIMI** (pasaportë), të dhëna nga organi përkatës i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- 3) **LETËRNJOFTIM**, vlefshmëria e së cilës ka skaduar në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së tyre.


Gjatë zgjedhjeve, këto tre dokumente konsiderohen dokumente adekuate për identifikim personal.



PROCESI I VOTIMIT ZHVILLOHET
EKSKLUZIVISHT SIPAS RENDIT NË
VIJIM:

1. VERIFIKIMI I DOKUMENTEVE PËR IDENTIFIKIM PERSONAL
2. KONTROLLI ME PAJISJE PËR IDENTIFIKIM BIOMETRIK
3. KONTROLLIMI DHE NËNSHKRIMI NË LISTËN E VOTUESVE
4. DHËNIA E FLETËS SË VOTIMIT
5. VOTIMI PAS PARAVANËVE TË VOTIMIT
6. VENDOSJA E FLETËVE TË VOTIMIT NË KUTITË E VOTIMIT





HAPI


2

IDENTIFIKIMI BIOMETRIK I VOTUESIT

Zgjedhësi identitetin personal e vërteton edhe me gjurmë gishti.

Zgjedhësi nuk mund të votojë nëse nuk ka dokument adekuat për identifikim personal apo nëse gjurma e gishtit nuk përputhet me gjurmën e gishtit në listën elektronike zgjedhore, edhe kur ai/ajo gjendet në Listën Zgjedhore.

Këshilli Zgjedhor përmes të dhënave nga dokumenti adekuat identifikimi personal dhe leximit të gjurmës së gishtit që duhet të përputhet me gjurmën e gishtit të votuesit në listën elektronike zgjedhore për një vend votimi, me pajisje teknike verifikon identitetin dhe kryen kontroll nëse votuesi ka votuar paraprakisht.



HAPI

3

KONTROLLI DHE NËNSHKRIM I ÇERTIFIKATAVE NGA LISTA ZGJEDHORE

Pas verifikimit të identitetit tënd, KZ-ja kontrollon nëse të dhënat tua janë në Listën Zgjedhor.


Kur do të verifikohet se të dhënat tua janë në Listën Zgjedhore, KZ-ja:

- ⇒ Në Listën Zgjedhore do ta rrethojë numrin rendor para emrit tënd
- ⇒ Do të kërkojë nga ty të nënshkruhesh në listen zgjedhore, në grafën anash emrit tënd

Vërejtje:

Lista Zgjedhore përmban edhe fotografi të votuesve.

Fotografia jote personale në listë do të jetë në formatin e njëjtë si në letërnjoftim dhe në pasaportë.




HAPI

4

LËSHIMI I FLETËS SË VOTIMIT

Pasi që të jesh nënshkruar në Listën Zgjedhore, KZ-ja do të ndërmarrë veprimet në vijim:

- ⇒ nga blloku me fletëvotime do ta grisë një fletë votimi
- ⇒ atë fletëvotim do ta vulosë në pjesën e parme në vendin e caktuar për vulë
- ⇒ do të ta dorëzojë fletëvotimin
- ⇒ do ta shpjegojë detajisht teknikën e votimit



DHËNIA E FLETËVOTIMEVE

Drejttohesh kah paravanët për votim për të votuar.


Votohet pas paravanit për votim, **duke rrethuar numrin rendor para propozuesit të listës së kandidatëve për të cilën do të votosh dhe atë ekskluzivisht me stilolaps kimik me ngjyrë të kaltër;**

Më pas, palos fletëvotimin në atë mënyrë që askush mos ketë mundësinë të shohë për kënd ke votuar.

VËREJTJE: Në qoftë se gaboni, nuk do të merrni fletëvotim tjetër.

**MBANI MEND!
SECILI VOTUES OSE VOTUESE VOTON VETË PAS PARAVANIT!
NJË VOTUES = NJË VOTË!
SHKELJA E FSHEHTËSISË SË VOTIMIT PARAQET VEPËR PENALE!**

The diagram illustrates the layout of a ballot paper. At the top, there are two header sections, each containing the word 'KOMUNA' (Municipality), the flag of Albania, and 'NUMRI I VENDVOTIMIT' (Number of seats). Below these are two rows of horizontal lines for writing. The main body of the ballot consists of a numbered list from 1 to 9. Each number is followed by two horizontal lines for the candidate's name and a small icon representing the candidate's party or organization. The number '2' is circled in blue, indicating the correct way to mark a choice. To the right of the ballot, there is a vertical grey bar representing the envelope, and a blue circular icon with a white 'X' inside, representing the official ballot paper.



Nuk lejohet fotografimi i fletës së votimit ose vendvotimit (çdo person që fotografon fletën e votimit do të gjobitet me dënim me para në shumë prej 450 deri në 1.500¹).

6

VOTIMI PAS PARAVANËVE TË VOTIMIT

HAPI

Vazhdo drejt kutisë së votimit dhe fut fletën në kuti.

Këshilli Zgjedhor nuk guxon të të lejojë ty ose dikujt tjetër ta braktisë vendvotimin pa futur fletëvotimin në kutinë e votimit. Kjo do të thotë që fletëvotimi në asnjë mënyrë nuk guxon të nxirret jashtë vendvotimit.


Në fund të votimit merr dokumentin për identifikim personal nga anëtarët e këshillit zgjedhor dhe largohu nga vendvotimi.



¹ Kodi Zgjedhor, neni 190, "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 42/2020

KËSHILLI ZGJEDHOR KA TË DREJTË MOS TË TË LEJOJË TË VOTOSH NË RAST SE:

- ⇒ emri yt nuk figuron në listën zgjedhore;
- ⇒ nuk posedon dokument përkatës identifikimi (letërnjoftim ose pasaportë);
- ⇒ nëse tanimë ke votuar;
- ⇒ refuzon të nënshkruesh në Listën Zgjedhore;



! ME RËNDËSI!

Nëse konsideron se e drejta jote zgjedhore është shkelur, ke mundësi të dorëzosh ankesë për mbrojtjen e së drejtës tënde zgjedhore. Në raste të tilla Këshilli Zgjedhor e ka për detyrë të të japë një formular të cilin duhet ta plotësosh dhe të të drejtojë te Komisioni Zgjedhor Komunal. Komisioni Zgjedhor e ka për detyrë të të japë formular me të cilin do ta parashtrosh ankesën ose të të drejtojë dhe të të ndihmojë gjatë plotësimit të formularit elektronik të ankesës të cilin mund ta gjeni në:
www.prigovori.sec.mk





5.

E DREJTA E VOTËS DHE MBROJTJA

E drejta e votës është e drejtë e garantuar e çdo qytetari.

Kjo e drejtë, e cila buron nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik, mbrohet nga Kodi Zgjedhor dhe e drejta ndërkombëtare.

E drejta juaj për të votuar është vetëm e juaja!

Askush nuk duhet t'ua marrë atë, as askush nuk mund të tregtojë me të ose t'ju bëjë shantazh dhe t'ju kërcënojë. Mos harroni kurrë se votimi është sekret, përkatësisht askush nuk mund të zbulojë se për kë votoni.

Nëse dikush përpiqet të shkelë fshehtësinë e votës suaj ose të dikujt tjetër, parashikohet dënim me burg për atë person, që do të thotë se paraqet vepër penale serioze që dënohet ashpër.

Për këto arsye, ne fletën e votimit e cila i jepet votuesit votueses nuk ka numër serik. Të gjitha fletët e votimit janë të njëjta.

MOS HARRONI

Procedura për mbrojtjen e votës suaj personale është urgjente.

Nëse mendoni se e drejta juaj për të votuar është shkelur ose rrezikuar në ndonjë mënyrë gjatë votimit ose jeni penguar të votoni, keni të drejtë të paraqisni ankesë në Komisionin komunal të zgjedhjeve (KKZ). Në rast të tillë, Këshilli zgjedhor është i detyruar t'ju japë të plotësoni formular në dy kopje në të cilin do të shpjegoni arsyet. Një kopje e ankesës detyrimisht do t'ju jepet juve.

Komisioni komunal i zgjedhjeve është i detyruar të lëshojë formular anekse për secilin votues që i drejtohet KKZ-së me qëllim të paraqitjes së ankesës, ose ta udhëzojë dhe ta ndihmuar të plotësojë formularin elektronik për parashtrimin e ankesës në www.prigovori.sec.mk

Komisioni komunal i zgjedhjeve është i detyruar të marrë vendim brenda 2 orëve pas pranimit të ankesës. Nëse ankesa juaj refuzohet, keni të drejtë për padi te Gjykata Administrative. Vendimi që do të merret nga Gjykata Administrative është përfundimtar.

Të gjitha ankesat e pranuar janë në dispozicion të publikut, mund t'i shikoni dhe të shihni statusin e tyre, natyrisht pa qasje në të dhënat private të parashtruesit.

Plotësuese:

Parregullsitë zgjedhore gjithashtu mund t'i raportohen Zyrës së Avokatit të Popullit, vëzhguesve zyrtarë dhe shoqatave qytetare. Ata, së bashku me ju, do të ndjekin më tej procedurën e ankesave të përcaktuar qartë në Kodin Zgjedhor, dhe të përshkruar në detaje në pjesën paraprake.

Shkelja e së drejtës për të votuar mund të raportohet drejtpërdrejt duke paraqitur denoncim në polici, përkatësisht deri te Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

Mos heshtni! Rezistoni ndaj cilitdo që përpiqet në çfarëdo mënyre të rrezikojë të drejtën tuaj ose të dikujt tjetër për të votuar!



6. PËRFSHIRJA NË PROCESIN ZGJEDHOR



6.1 ÇFARË DO TË THOTË PËRFSHIRJE APO GJITHËPËRFSHIRJE?

Përfshirje do të thotë inkluzion. Por për të kuptuar saktësisht se çfarë do të thotë termi përfshirje në proceset shoqërore, duhet të dimë se çfarë është barazi dhe çfarë është diskriminim.

Sipas legjislacionit vendas, si dhe sipas akteve ligjore ndërkombëtare në vendin tonë, mbizotëron parimi i barazisë dhe diskriminimi është i ndaluar.

„Barazia është parim sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë, përkatësisht të barabartë në qënimin dhe realizimin e të gjitha të drejtave dhe lirive“.¹²

Një person ose një grup njerëzish, burra dhe/ose gra, diskriminohen kur për shkak të një karakteristike të veçantë që ata e posedojnë u kufizohet një e drejtë të caktuar ose u kufizohet liria, ndërsa të cilat u garantohet ligjërisht të gjithë qytetarëve/qytetareve. Diskriminimi rezulton me atë që ai person ose grup të mos jetë në gjendje të gëzojë ose ushtrojë të gjitha të drejtat dhe liritë në mënyrë të barabartë si të gjithë të tjerët.

Karakteristikat e veçanta, që janë shkak për diskriminim dhe quhen baza diskriminuese janë: raca, ngjyra e lëkurës, origjina, kombësia ose etnia, gjinia, seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në një grup të marginalizuar, gjuha, shtetësia, origjina shoqërore, arsimi, feja, besimet fetare, politike ose të tjera, aftësi të kufizuara, moshë, statusi familjar ose martesor, gjendja pasurore, gjendja shëndetësore, statusi personal dhe statusi shoqëror, etj.

Persona të cilëve në vendin tonë nuk u lejohej të votojnë, janë personat të cilëve u është hequr aftësia e veprimit, dhe për të cilën gjykata ka përcaktuar se ata nuk kanë aftësi për ta shprehur vullnetin juridik relevant në zgjedhje.

Prandaj, procesi zgjedhor gjithëpërfshirës ose përfshirja në procesin zgjedhor do të thotë që të gjithë qytetarët e rritur kanë të drejtë të barabartë të marrin pjesë në procesin zgjedhor, pavarësisht nga gjinia, seksi, kombësia ose etnia e tyre, aftësia e kufizuar, ngjyra e lëkurës, origjina, arsimi, statusi shoqëror, besimet fetare ose politike, etj.

¹² Ligji për parandalimin dhe mbrojtje nga diskriminimi, neni 4, "Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 258/2020

E drejta dhe mundësia e të gjithë qytetarëve për të marrë pjesë në zgjedhje është thelbësore për demokracinë. Por, ndodh që, megjithëse e drejta e qytetarëve ekziston dhe garantohet nga ligjet, në praktikë nuk ka mundësi që të gjithë ta përdorin atë të drejtë.

Prandaj, shtetet, si dhe institucionet e tyre, kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin. Kjo përfshin **përdorimin e masave të veçanta të përkohshme, shpesh të referuara si masa afirmative ose stimuluese, të cilat synojnë të eliminojnë gëzimin e pabarabartë të të drejtave dhe lirive të njeriut derisa të arrihet barazia faktike e personit ose grupit, ose të inkurajojnë dhe mundësojnë pjesëmarrje të barabartë në praktikë.** Ne do të shpjegojmë se çfarë do të thotë kjo në praktikë përmes shembujve të personave me aftësi të kufizuara dhe grave, megjithëse ka grupe të tjera që gjithashtu kanë nevojë për masa inkurajuese shtesë.

6.2 PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Personat me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi në ushtrimin e të drejtave të tyre të votës si në rolin e votuesit/votueses, edhe në rolin e kandidatit / kandidatës, në rolin e të punësuarve në administratën zgjedhore dhe në rolin e vëzhguesve të zgjedhjeve.

Për shembull, vetëm një nga pengesat e shumta është mos pasja e qasjes në qendrat e votimit. Kështu, nëse te objekti për votim duhet të arrihet me shkallë dhe nuk sigurohet rampë ose ashensor, një person që përdor karrocë ose mjete të tjera ndihmëse për të lëvizur nuk është në gjendje të arrijë në qendrën e votimit dhe të ushtrojë të drejtën e tij të votës, as do të jetë në gjendje të marrë pjesë si vëzhgues / vëzhguese ose anëtar/ anëtare i/e KZ-së.

Personat me shikim të dëmtuar dhe të verbrit nuk janë në gjendje të lexojnë fletët e votimit dhe të bëjnë zgjedhjen e tyre. Prandaj, është e nevojshme të përpunohen shabllone të veçanta me alfabetin e Braevit në mënyrë që të mund të votojnë në mënyrë të pavarur, nëse e njohin alfabetin e Braevit. Nëse nuk është ky rast, autoritetet zgjedhore janë të detyruara t'i sigurojnë ndihmë gjatë votimit këta persona.

Si i ri, mund t'ju ndodhë që gjatë votimit anëtar i KZ-së t'ju kërkojë të ndihmoni një person me aftësi të kufizuara të ushtrojë të drejtën e tij. Kjo lejohet me ligj dhe duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga anëtar i KZ, gjithmonë duhet të ofroni ndihmë. Në të njëjtën kohë, nuk duhet të harroni se nuk bëni zgjedhjen në vend të personit me aftësi të kufizuara, por vetëm e ndihmoni atë, të përfundojë teknikisht operacionin e votimit.

Gjatë fushatave parazgjedhore, personat me aftësi të kufizuara të ndryshme shqisore (të verbër, me shikim të dëmtuar, të shurdhër dhe me pengesa në dëgjim) gjithashtu përballen me mungesë informacioni në një format që është i arritshëm për ta. Kështu, ata mbeten të privuar nga informacione shumë të rëndësishme, të cilat i pengojnë ata të shfaqen në rolin e kandidatëve për opsione të caktuara politike, ose të marrin pjesë aktive në ndonjë pjesë të procesit zgjedhor. Deri më tani, në vendin tonë, asnjë person me aftësi të kufizuar nuk është zgjedhur deputet/ deputete në Parlament, kryetar/ kryetare i/e Komunës, as nuk është emëruar ministër/ ministre në Qeveri.

Të rinjtë me aftësi të kufizuara përballen me të gjitha këto probleme. Edhe pse në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka regjistrer të saktë të personave me aftësi të kufizuara, duke pasur parasysh që në botë 15% e popullsisë ka një lloj aftësie të kufizuar¹³ dhe duke marrë parasysh që rreth 15% e popullsisë së përgjithshme në vendin tonë është e moshës 18-29 vjeç, është e lehtë të llogaritet se rreth 40,000 të rinj me të drejtë vote në vendin tonë kanë një lloj aftësi të kufizuar.¹⁴

Pjesëmarrja rinore dhe aktivizimi, ndër të tjera, përfshin aktivitete për të përmirësuar mundësitë për pjesëmarrjen e të rinjve me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor.



13 Burimi: Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)

14 Llogaritja jozyrtare sipas të dhënave në dispozicion të publikut nga regjistrimi i kryer në 2002 nga Zyra Shtetërore e Statistikave

6.3. PJEËMARRJA E GRAVE

Ka rreth 155.000-170.000 gra të reja në Maqedoninë e Veriut, të moshës 18-29¹⁵ vjeç që mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin zgjedhor, të kandidojnë për zyra, të zgjidhen, të votojnë dhe të marrin pjesë në administratën zgjedhore. Por, edhe pse ligjet garantojnë trajtim të barabartë për gratë dhe burrat, në praktikë gratë janë dukshëm më pak të përfshira në politikë. Ky nuk është rasti vetëm tek ne. Gratë në të gjithë botën përballen me pengesa politike, sociale, ekonomike, ligjore dhe kulturore ose parandaluese për të marrë pjesë në proceset zgjedhore.¹⁶

Kjo, është për shkak të stereotipave dhe paragjytimeve ekzistuese, normave patriarkale, por edhe për pengesat sistematike që ekzistojnë sepse shumë herë problemi mbetet i padukshëm. Ndodh shpesh që disa procese konsiderohen plotësisht neutrale dhe nuk vërehet se ato ndikojnë mbi burrat ndryshe sesa mbi gratë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të ketë statistika të ndara sipas gjinisë, dhe sipas moshës për të gjitha proceset, si dhe për zgjedhjet. Me të dhëna të tilla, është e mundur të planifikohen aktivitete stimuluuese që do të përmirësojnë situatën. Një nga masat më të njohura inkurajuese është vendosja e kuotave. Kuotat nuk vlejnë domosdoshmërisht vetëm për gratë, por për gjininë më pak të përfaqësuar, sepse në rrethana të caktuara mund të ndodhë që burrat të përfaqësohen më pak. Prandaj, kur bëhet fjalë për kandidatët që garojnë në zgjedhje, **Kodi Zgjedhor përcakton që 40% e kandidatëve/kandidateve duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar. Në rastin tonë, janë kryesisht gratë.**

Për të promovuar barazinë edhe në organet zgjedhore, Kodi Zgjedhor përcakton që në përbërjen e organeve zgjedhore secila gjini do të përfaqësohet me të paktën 30%.

Sigurisht, madje edhe masat të tilla inkurajuese dhe afirmative nuk garantojnë barazi, dhe ka akoma shumë hapësirë për përmirësim.

Disa gra përballen me pengesa dhe diskriminim shtesë për shkak të fesë, grupit etnik, gjuhës, aftësisë së kufizuar ose për shkak se janë të varfra, rurale, me nivel të ulët të arsimimit, nuk kanë letërnjoftim, ose për shkak se janë të reja. Atëherë bëhet fjalë për të ashtuquajturin diskriminim të shumëfishtë ose ndër-sektorial.¹⁷

¹⁵ Sipas regjistrimit të vitit 2002, Enti Shtetëror i Statistikave, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/PDFGodisnik2013/03-Nase-lnie-Population.pdf>

¹⁶ Doracak për praktikant më të mira IFES, f. 8-9

¹⁷ Diskriminimi ndërsektorial është çdo diskriminim në dy ose më shumë baza diskriminuuese që janë të lidhura në të njëjtën kohë dhe të pazgjidhshme. Shih: Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, neni 4, "Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 258/2020

Është vërejtur se votimi familjar prek më shpesh gratë, veçanërisht në zonat rurale. Kjo do të thotë që mund të ndodhë veçanërisht në rastin e grave të reja, një anëtar tjetër i familjes më i moshuar, babai, vëllai, burri të ndikojnë në vendimin për kë do të votojë.

**JU DUHET TA DINI QË KENI TË DREJTË TË VENDOSNI PËR KË TË VOTONI
DHE DUHET TË MERRNI VENDIMIN TUAJ.**

Në rastin e grave që paraqiten si kandidatë, është vërejtur se gjatë fushatave politike gjuha e urrejtjes është më e përhapur ndaj grave sesa ndaj burrave, si dhe madje është edhe më e theksuar nëse është një grua e re. Shpesh jemi dëshmitarë të komenteve abuzive ose seksiste për politikane ose aktiviste të reja, veçanërisht në rrjetet sociale dhe media.

ZGJEDHJET GJITHËPËRFSHIRËSE JANË NJË NGA PARIMET THEMELORE TË PROCESIT ZGJEDHOR DEMOKRATIK.

Të rinjtë, veçanërisht gratë e reja, nuk duhet të ekspozohen ndaj gjuhës së urrejtjes, nënvlerësimit, fyerjeve dhe formave të tjera të ngacmimit në çdo angazhim politik, aktivizëm ose ndonjë formë tjetër të pjesëmarrjes në procesin zgjedhor.

KSHZ-ja është e detyruar dhe bën vazhdimisht përpjekje dhe prezanton masa për të përmirësuar kushtet dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve më të vogla dhe të gjitha grupeve të tjera të cilat mund të pengohen të marrin pjesë në procesin zgjedhor.



7.

BËHU NDRYSHIMI QË DËSHIRON TË SHOHËSH



Më shumë se një shekull ka kaluar që nga kjo thënie e famshme e Mahatma Gandit, një prej udhëheqësve më të mëdhenj të shekullit të 20-të dhe njeriut që arriti të çlironte Indinë nga skllavëria koloniale me mjete jo të dhunshme.

Por çfarë thotë në të vërtetë Gandhi në vitin 1913:

”

„Ne jemi pasqyrë e të gjithë botës ... Nëse ndryshojmë veten, do të ndryshojmë botën.“

”

Le të jetë ky mesazh një nxitje dhe motivim për secilin prej nesh, veçanërisht për të rinjtë. Ata nuk janë vetëm e ardhmja, por mbi të gjitha e tashmja e vendit tonë, por edhe e gjithë botës. Përfshirja e të rinjve dhe idetë e tyre inovative dhe zgjidhjet krijuese kontribuojnë në ndryshime pozitive në proceset e përgjithshme në shoqërinë në të cilën jetojmë. Secili di për veten e vet dhe ka të drejtë të vendosë se çfarë është më e mira. Zgjedhjet janë akti suprem demokratik për të cilin secili prej nesh vendos dhe hedh bazat e demokracisë.

Cilat shkolla do të ndjekin nxënësit, a do të kemi punë të sigurta dhe të mbrojtura, cili do të jetë pozicioni i të rinjve në shoqëri, si të zvogëlohet papunësia e të rinjve, çfarë është e nevojshme për të përmirësuar kujdesin shëndetësor mendor të të rinjve janë një pjesë e zgjedhjes së zgjidhjeve që ne fillojmë të bëjmë në ditën e zgjedhjeve.

Vetëm me këtë qasje institucionet mund të ndërtojnë partneritete me të rinjtë. Në të njëjtën kohë, premtimet elektorale të kandidatëve duhet të jenë të arritshme dhe të përfshijnë pritjet dhe nevojat e të rinjve. Mënyra më e mirë për të arritur këtë është motivimi dhe inkurajimi i të rinjve që të përfshihen në proceset shoqërore dhe përmes mjeteve konvencionale, pra përmes votimit, të ndikojnë drejtpërdrejt në trendet socio-politike.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është partner i fortë i të rinjve në të gjitha proceset zgjedhore dhe referendume.

KONTAKTONI ME KSHZ-NË, SUGJERO IDE OSE PROJEKT, BASHKOHU! BËHU NDRYSHIMI QË DËSHIRON TË SHOHËSH!

**Rruga: Shën Kirili dhe Metodi
nr.54, Shkup 1000**


Faqe interneti: www.sec.mk

Faqja në Facebook: www.facebook.com/drzavna.izborna.komisija

**Email: izbori@sec.mk,
izbirackispisok@sec.mk**

Telefoni: +389 2 3244744

Faksi: +389 2 3244745





8.

**PYETJE DHE
DILEMA QË TË
RINJTË SHPESH
IA ADRESOJNË
KSHZ-SË**



pyetje

1

EDHE ASHTU NUK KISHA TË DREJTË VOTE DERI TANI, ÇFARË DO TË NDRYSHOJË TANI?

Ditëlindja juaj e tetëmbëdhjetë nuk është aq e zakonshme sa të gjitha të mëparshmet. Në atë ditë ju bëheni person i rritur, që do të thotë që keni të drejtë të merrni vendime për jetën tuaj. Por asnjë e drejtë nuk vjen pa përgjegjësi. Prandaj, mosha madhore, përveç mundësisë të gëzoni plotësisht të drejtat tuaja të garantuara me ligj, ju gjithashtu fitoni obligimin për përgjegjësi personale. Kjo do të thotë që jeni përgjegjës/ përgjegjëse për vendimet dhe veprimet dhe vetë mbani përgjegjësi për pasojat e tyre. Ditën kur mbushni 18 vjeç ju merrni të drejtën e votës.

Është përcaktuar në Kodin Zgjedhor, i cili rregullon në mënyrë ligjore procesin e zhvillimit të zgjedhjeve në vendin tonë. Aty thuhet: «Çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka vendbanim të përhershëm në njësinë zgjedhore, komunën, përkatësisht Qytetin Shkup, ku zhvillohen zgjedhjet, ka të drejtë vote.»

Me fjalë të tjera, ditën që mbushni 18 vjeç keni të drejtë të vendosni se kush do të jetë kryetari ose kryetarja i komunës ose kush do të jenë këshilltarët dhe këshilltareset që do t'ju përfaqësojnë në komunën tuaj ose Qytetin e Shkupit. Ke të drejtë të vendosësh se cilët deputetë dhe deputete do të përfaqësojnë të drejtat dhe interesat tënde në Kuvend dhe pikërisht deputetët dhe deputetet janë ata që zgjedhin më tej Qeverinë. Gjithashtu keni të drejtë të votoni në zgjedhjet presidenciale dhe të vendosni se kush do të jetë Presidenti ose Presidentja i/e Republikës për pesë vitet e ardhshme, saç zgjat mandati i Presidentit / Presidentes të vendit. Si i rritur, fiton të drejtën të jesh person i barabartë në edhe në vendimmarrje për çështje të ndryshme në referendum, në nivel kombëtar ose lokal.

E drejta për të votuar dhe për të vendosur nuk është vetëm një mundësi ligjore. Është mundësia më e mirë për ju si person i barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë në vend, të merrni pjesë aktive në krijimin e shoqërisë në të cilën jetoni. Duke vepruar kështu, ju në të vërtetë ndikoni në krijimin e jetës suaj, domethënë po ndikoni në vendimet që autoritetet marrin në emrin tuaj për të gjitha segmentet e jetës. Për shembull, çfarë arsim, shëndetësi, kulturë, sport apo infrastrukturë rrugore do të jetë në dispozicion për ju, në çfarë mjedis jetësor do të jetoni, nëse do të gëzoni të drejtat për t'u mbrojtur nga diskriminimi. Sa dhe cilat mundësi do të jenë në dispozicion për çdo të ri varet pikërisht nga vendimi juaj dhe vota që ju jepni në zgjedhjet parlamentare, presidenciale dhe lokale.

pyetje

2

DO TË ISHTE KULL NËSE DO TË BËJA SELFIE ME CELULARIN TIM GJATË VOTIMIT? DO TË JETË NJË HIT I VËRTETË NË INSTAGRAM ...

Mediat sociale janë shumë të popullarizuara jo vetëm në mesin e të rinjve, por edhe midis të gjitha brezave të rritur. Pothuajse secili prej nesh sot njih shumë njerëz që janë aktivë në internet dhe kanë Facebook, Instagram ose komunikojnë përmes Viber ose WhatsApp.

Por është e rëndësishme të dini se gjatë votimit, është e ndaluar të fotografosh fletën e votimit me celular ose aparat fotografik.

Ky ndalim u vendos me qëllimin e vetëm për të mundësuar fshehtësinë e votimit, të eliminohet çdo mundësi abuzimi me procesin e votimit. Me një fjali, kjo synon të lejojë secilin prej nesh të ndihet i sigurt, i mbrojtur dhe i gjithë procesi zgjedhor të jetë demokratik, i drejtë dhe i lirë.

Gjithashtu ndalohet rreptësishtë mbajtja e çfarë do lloji arme në qendrat e votimit, si dhe të votimi në emër të dikujt tjetër, si dhe votimi familjar ose çfarëdo forme e votimit në grup.

Nëse ju ose ndonjë votues tjetër nuk i përmbaheni këtyre ndalimeve, mund të largoheni nga qendra e votimit.

pyetje

3

SI MUND TA DI NËSE JAM NË LISTËN E VOTUESVE? KUSH MUND TË MË TREGOJË?

Çdo qytetar që ka mbushur 18 vjeç dhe një dokument të vlefshëm për identifikim personal (letërnjoftim ose pasaportë) është regjistruar në Listën e votuesve. Lista e Votuesve nuk përfshin shtetasit të cilëve u është hequr plotësisht aftësia juridike me vendim gjyqësor të formës së prerë ose pjesërisht i janë privuar nga zotësia e tyre juridike me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe gjykata ka përcaktuar se personi nuk ka aftësinë për të shprehur ligjërisht vullnetin përkatës në zgjedhje.

Kontrolli për atë nëse jeni në Listën e votuesve dhe në cilin vend të votimit mund të votoni mund të bëhet në: www.izbirackispisok.gov.mk

pyetje

4

PSE NUK MUND TË VOTOJ ME MIKUN TIM NË TË NJËJTIN VEND VOTIMI? NUK JETOJMË NË TË NJËJTËN LAGJE POR JEMI TË PANDARË NË SHKOLLË

Kodi zgjedhor përcakton se “Lista e votuesve është dokument publik dhe udhëhiqet për të gjithë territorin e Republikës. Në bazë të Listës së votuesve, zgjedhjet dhe referendumet kryhen në nivelin shtetëror dhe lokal.”

Për organizim më të mirë dhe më të lehtë të procesit të votimit, votimi organizohet në 3.480 vendvotime në vend dhe deri në 52 vendvotime jashtë vendit. Pikërisht menaxhimi apo organizimi i mirë që është më i rëndësishëm në çdo sferë, përfshirë edhe gjatë zhvillimit të zgjedhjeve nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ)

Secili votues regjistrohet në listën e zgjedhësve për të votuar në qendrën e votimit më afër vendbanimit të tij / saj të shënuar në letërnjoftimin.

pyetje

5

NGA U GJENDËN TË DHËNAT E MIA NË LISTËN E VOTUESVE?

Në tre dekadat e kaluara, procesi zgjedhor në vendin tonë po përmirësohet vazhdimisht. Ky është një nga qëllimet kryesore të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Për zbatimin e suksesshëm të të gjithë procesit të votimit, Ministria e Punëve të Brendshme i paraqet KSHZ-së, ndër të tjera, të dhëna për shtetasit mbi 18 vjeç, të cilët në ditën e zgjedhjeve kanë letërnjoftim ose pasaportë adekuat. Ministria e Punëve të Brendshme gjithashtu paraqet raport në KSHZ katër herë në vit mbi letërnjoftimet dhe pasaportat e lëshuara, baza për lëshimin e tyre, dhe të sistematizuara sipas emrit, mbiemrit dhe komunës.

Pikërisht, të dhënat për secilin votues bëhen pjesë integrale e Listës së votuesve. Këto të dhëna nuk janë publike dhe përdoren vetëm për të ushtruar të drejtën e votës në ditën e zgjedhjeve ose referendumin.

pyetje

6

SI MUND TË VENDOS PËR KË TË VOTOJ?

Vota juaj është vetëm e drejta juaj. Askush përveç jush nuk ka të drejtë të vendosë ose në ndonjë mënyrë tjetër t'ju bëjë të votoni ose jo për një kandidat/ kandidatë të caktuar ose parti politike.

Secili prej nesh vendos personalisht për kë të votojë dhe nëse do të ushtrojë të drejtën e vet për të votuar.

Gjithmonë duhet të jeni mirë të informuar për programet që secili kandidat/ kandidatë ofron në zgjedhjet e ardhshme, ndani mendimin tuaj me këdo në të cilin keni besim, por mos harroni se vendimi merret nga ju dhe askush tjetër.

pyetje

7

A DUHET TË DËGJOJ PRINDËRIT E MI PËR KË TË VOTOJ?

Askush nuk ka të drejtë të ndikojë mbi ju se për kë të votoni. Kjo vlen edhe për prindërit tuaj. E drejta për të votuar është vendim personal, individual që ne e marrim në mënyrë të pavarur.

Vetëm ju dhe fletëvotimi jeni mbrapa paravanit të votimit.

pyetje

8

MIRË, POR PSE TË MOS I DËGJOJ MIQTË/ MIKET ME TË CILËT SHOQËROHEM ÇDO DITË?

E njëjta gjë vlen edhe për miqtë më të afërt apo të ngushtë. Mos harroni kurrë, se vota juaj është vetëm e drejta juaj.

Vendimi që ne marrim është personale dhe vendimtare për atë se çfarë shoqërie do të jetojmë, çfarë lloj arsimit, shëndetësisë apo mundësi do të kemi për të rinjtë në të ardhmen.

pyetje

9

PSE KUR DO TË VIJ TË VOTOJ, MOS MË JEPNI PROGRAMIN E KANDIDATËVE DHE KANDIDATEVE T'I LEXOJ DHE VENDOS PËR KË TË VOTOJ?

Partitë politike, kandidatët dhe kandidatet, me ligj, kanë mundësinë të bëjnë fushatë parazgjedhore. Gjatë asaj periudhe, ata përdorin të gjitha format e komunikimit me votuesit dhe votueset e tyre, të tilla si komunikimi i drejtpërdrejtë dhe indirekt, përfaqësimi midis mediave ose komunikimit dhe promovimit të dyanshëm nëpërmjet mediave sociale.

Por, një ditë para zgjedhjeve, si dhe gjatë procesit të votimit në të gjithë territorin e vendit, fillon e ashtuquajtura heshtja parazgjedhore. Kjo do të thotë që partitë, kandidatët dhe kandidatet, mbështetësit e tyre dhe kushdo tjetër nuk kanë të drejtë të përfshihen në ndonjë aktivitet promovues, duke përfshirë edhe shpërndarjen e materialit propagandistik, agjitacionin dhe bindjen për të votuar ose për të mos votuar për kandidatë të caktuar.

Përveç kësaj, Kodi Zgjedhor ndalon qartë propagandën dhe parashikon heqjen e të gjitha materialeve propagandistike (postera, fletëpalosje, etj.) nga dhoma ku ndodhet qendra e votimit, si dhe jashtë në afërsi të drejtpërdrejtë brenda një rrezeje prej 100 metrash nga qendra e votimit. Këshilli zgjedhor në secilin vend të votimit është i detyruar të sigurojë që askush të mos lërë material propagandistik ose shënime me emrin e ndonjërit nga paraqitësit e listave të kandidatëve dhe kandidateve. Nëse ka të tilla, ai i heq ato menjëherë para fillimit të procesit të votimit.

pyetje

10

SI MUND TË JEMI TË SIGURT SE ASKUSH NUK DO TA DIJË KUSH VOTON PËR KË?

E drejta e fshehtësisë së votës garantohet me Kushtetutë. Organet zgjedhore janë ato që sigurojnë që çdo qytetar mund të votojë në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë, me të drejtë vote të barabartë. Pikërisht administrata zgjedhore është përgjegjëse për identifikimin dhe parandalimin e përpjekjeve eventuale për të prishur fshehtësinë e votimit.

ÇDO VOTUES/VOTUESE VOTON NË MËNYRË TË PAVARUR MBRAPA PARAVANIT! NJE VOTUES/E = NJE VOTË!

Shkelja e fshehtësisë së votimit përbën vepër penale!

Kodi Zgjedhor parashikon shkeljen e sekretit të votimit, si dhe votimin për një person tjetër, si arsye për anulimin e votimit në qendrën e votimit. Prandaj, të gjitha fletët e votimit janë të njëjta, përkatësisht asnjë nga fletët e votimit që i janë dhënë votuesit nuk përmban numër serik.

pyetje

11

NËSE NUK VOTOJ, A MUND TË VOTOJË DIKUSH TJETËR NË VENDIN TIM?

Askush nuk mund të votojë për një person tjetër. Kjo ndalohe rreptësisht në Kodin Zgjedhor.

Marrja e vendimit për mënyrën se si secili prej nesh do të vendosë të ushtrojë të drejtën tonë të garantuar për të votuar është personale!

Është e rëndësishme të theksohet se keni të drejtë të vendosni të mos ushtroni të drejtën tuaj për të votuar dhe për të mos votuar. Por në atë rast duhet të dini se vendimi për zgjedhje do të merret nga qytetarët që vendosën të votojnë në zgjedhje.

pyetje

12

A DO TË KEM MË SHUMË SHANSE PËR TË GJETUR VEND PUNE NËSE VOTOJ?

Askush nuk ka të drejtë të tregtojë me të drejtën e tij për të votuar. Është e drejtë personale që secili prej nesh mund ta ushtrojë ditën e zgjedhjeve.

Për më tepër, çdo përpjekje për ryshfet nga kandidatët ose kandidatet, përfaqësuesit e partive politike ose ndonjë person tjetër konsiderohet si vepër e rëndë dhe krim i rëndë.

Kodi Zgjedhor përcakton qartë se „dhënia ose premtimi i dhuratës, ose përfitimi tjetër për vete ose një tjetër, për votues gjatë zgjedhjeve dhe ose votimi në referendum, të votojë ose jo, ose të votojë për një kandidat ose vendim të veçantë, konsiderohet ryshfet gjatë zgjedhjeve dhe votimit „. Për shkeljen e tillë dhe për shkelësit parashihen sanksione serioze me burg.

Për më tepër, ligji shkon një hap më tej dhe parashikon anulimin e vendeve (mandateve) të fituara nga kandidatët/ kandidatet nëse përcaktohet se ata përdorën ryshfet dhe fonde nga veprat e kryera penale si mjet për marrjen e votave.

pyetje

13

PSE TË DAL DHE TË SHKOJ NË VENDVOTIM KUR MUND TA BËJ KËTË NËPËRMJET INTERNETIT?

Për momentin, në vendin tonë nuk ka asnjë mënyrë për të votuar me postë, e-mail ose ndonjë formë tjetër të votimit në internet.

Kodi Zgjedhor përcakton që çdo qytetar ose qytetare që dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij / saj të votës, mund ta bëjë këtë në ditën e zgjedhjeve në periudhën midis orës 7 dhe 19, në qendrën e votimit ku është regjistruar në Listën e votuesve.

pyetje

14



KAM MIK QË ËSHTË PERSON I VERBËR, DHE NË KËTO ZGJEDHJE AI ËSHTË 18 VJEÇ DHE MUND TË VOTOJË. SI DO TA USHTROJË AI TË DREJTËN E TIJ?

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i kushton vëmendje të veçantë përfshirjes së secilit qytetar me të drejtë vote në procesin zgjedhor.

Qëllimi themelor i të gjitha organeve të administratës zgjedhore është dhe duhet të jetë mundësia e barabartë e votimit për çdo votues!

Kjo është arsyeja pse votimi i votuesve që kanë nevojë për ndihmë është pjesë e veçantë dhe e rëndësishme e Kodit Zgjedhor.

Ka disa mundësi që këta njerëz të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar pa pengesa. Opsioni i parë është nëse ata e dinë alfabetin e Braevit që të përdorin modele të veçanta për të qenë në gjendje të votojnë në mënyrë të pavarur.

Opsioni i dytë, Kodi Zgjedhor, përcakton se „votues që është i verbër, ka një paaftësi fizike ose është analfabet dhe për këtë arsye nuk mund të votojë në mënyrë të përcaktuar nga Kodi, ka të drejtë të sjellë një person për ta ndihmuar gjatë votimit.

Në mënyrë që të mbrohet i gjithë procesi zgjedhor nga abuzimet e mundshme, parashikohet që i njëjti person mund të sigurojë ndihmë vetëm për dy votues të cilët nuk janë në gjendje të votojnë.

Mundësia e tretë e ofruar për qëllimin e procesit gjithëpërfshirës të votimit dhe mundësimit që çdo qytetar/ qytetare të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar, ndërsa nuk është në gjendje të votojnë në qendrën e votimit (person i pamundur ose i sëmurë) është evidentimi në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe votimi para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

pyetje

15



SHPESH SHOH OSE LEXOJ INFORMACIONE RRETH NJERËZVE QË VOTOJNË NJË DITË TJETËR NGA DITA E CAKTUAR PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE. SI ËSHTË E MUNDUR?

Është e rëndësishme të theksohet edhe një herë se është me rëndësi të paçmueshme për të gjithë që të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Në fakt, votimi është themeli ose shtylla e çdo shteti demokratik. Vetëm në këtë mënyrë mund të flasim për qeveri të zgjedhur në zgjedhje të drejta, demokratike dhe të lira.

Kjo është arsyeja pse Kodi Zgjedhor parashikon mundësinë e votimit një ditë para zgjedhjeve. Kjo mundësi është e përcaktuar qartë dhe saktë dhe i referohet votimit të personave me aftësi të kufizuara ose të sëmurë, si dhe votimit të personave që vuajnë dënimin me burg, në paraburgim ose janë persona të zhvendosur brenda vendit dhe persona në shtëpi pleqsh.

Personat me aftësi të kufizuara ose të sëmurë votojnë në shtëpitë e tyre ose vendet / qendrat ku janë akomoduar. Personat që vuajnë dënimin me burg ose në paraburgim votojnë në burgje, ndërsa personat e zhvendosur brenda vendit ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar një ditë më parë, por në qendrat e personave të zhvendosur brenda vendit si dhe të moshuarit e vendosur në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit.

pyetje

16



PSE NUK KA MJAFT TË RINJ NË LISTAT E VOTUESVE?

Të rinjtë janë pjesë e rëndësishme e çdo shoqërie. Ata janë po aq të rëndësishme si të gjitha grupmoshat e njerëzve. Kjo do të thotë që të rinjtë duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në listat e votuesve të kandidatëve dhe kandidatëve që janë vetëkandiduar ose janë propozuar nga partitë politike dhe koalicionet.

Por, Kodi Zgjedhor, ose ndonjë dokument tjetër ligjor, nuk e lejon Komisionin Shtetëror i Zgjedhjeve ose organet e tjera të administratës zgjedhore të ndërhyjnë në vendimet e paraqitësve për përbërjen e listave të kandidatëve dhe zgjidhjeve personale.

Autoritetet zgjedhore sigurojnë zbatimin e plotë të procesit të votimit si demokratik, të drejtë dhe transparent, ku të gjithë lejohen të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre të votës.

pyetje

17



PSE DUHEN DITË DERISA TË SHPALLEN FITUESIT? A ËSHTË KAQ E VËSHTIRË TË NUMËROHEN VOTAT?

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është organi më i lartë përgjegjës për kryerjen e të gjitha zgjedhjeve dhe referendumeve në vendin tonë. Prandaj, KSHZ-ja i kushton vëmendje të veçantë hapjes dhe transparencës në punën e saj, por në të njëjtën kohë kujdeset të sigurojë vetëm informata të sakta, të verifikuara dhe të besueshme mbi rrjedhën dhe rezultatet e zgjedhjeve dhe referendume.

Për më tepër, rezultatet fillestare jozyrtare azhurnohen minutë pas minute dhe publikohen në mënyrë transparente dhe janë në dispozicion të publikut për të gjithë përmes faqes zyrtare të KSHZ-së: www.rezultati.sec.mk.

Arsyeja pse KSHZ-ja shpall rezultatet zyrtare pas një kohe të caktuar është sepse duhet të kontrollojë përmbajtjen e saktë të të gjitha procesverbaleve për përmbledhjen dhe përcaktimin e rezultateve nga vendvotimet, si dhe procesverbalet për përmbledhjen dhe përcaktimin e rezultateve të komisioneve komunale të zgjedhjeve.

Rezultatet zyrtare shpallen nga KSHZ -ja pas përfundimit të të gjitha procedurave të ankesave. Vetëm në këtë mënyrë mundësohet dhe garantohet procesi zgjedhor, i cili është i rregullt, i drejtë dhe i besueshëm, ku çdo votues / votuese mund të ushtrojë lirisht të drejtën e tij / saj të votës.

pyetje

18

EDHE UNË DUA TË KANDIDOJ DHE TË BËHEM PRESIDENT/ PRESIDENTE APO PJESË E DEPUTETËVE/ DEPUTETEVE DHE LISTAVE PËR KRYETARË/ KRYETARE TË KOMUNAVE?

Të drejtën për të paraqitur listë të kandidatëve për deputetë/ deputete, listë të kandidatëve për anëtarë/anëtare të këshillit, përkatësisht listë të kandidati për kryetar / kryetare të komunës kanë partitë politike të regjistruara në mënyrë të pavarur, koalicionet, si dhe një grup votuesish.

Për më tepër, Kodi Zgjedhor përcakton si „kandidat i pavarur“ kandidatët / kandidatet për zgjedhjen e Presidentit / Presidentes së Republikës, deputet / deputete, kryetar/ kryetare të komunës ose anëtar / anëtare të këshillit të cilët mbështeten nga një grup votuesish në përputhje me numrin e përcaktuar ligjërisht të nënshkrimeve të mbledhura.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve inkurajon të gjithë qytetarët të cilët synojnë të (vet) garojnë në zgjedhjet e ardhshme, që të studiojnë rregulloret ligjore në mënyrë që ata të mund ta ushtrojnë këtë të drejtë ose të kontaktojnë KSHZ-në e cila do t'u japë të gjithë informacionin e nevojshëm.



LITERATURA E PËRDORUR:

1. D. Kosturanova, I. Davidovska, I. Jovanov, *“Organizimi Rinor në Maqedoni”, Këshilli Rinor Nacional*, 2013
2. Komisioni shtetëror i zgjedhjeve, *Doracak për edukimin e anëtarëve të Komisioneve komunale të zgjedhjeve, këshillave zgjedhorë dhe këshillave zgjedhorë për realizimin e votimit jashtë vendit në PDK*, 2020, <https://drive.google.com/file/d/1ZURxnQj6Q3zZv2pXyNqLExMSZS2nBFwl/view>
3. Dushica Perishiq dhe të tjerë, *Doracak për kryetarët dhe këshilltarët e komunave për kompetencat e vetëqeverisjes lokale*, Shkup, 2017
4. E. Kochoska, *Analiza e pjesëmarrjes politike të personave me aftësi të kufizuara*, Misioni i OSBE-së në Shkup, 2017 (në dispozicion në: <https://www.osce.org/mission-to-skopje/410309>)
5. Z. Ilieski, *Doracak mbi politikën e rinisë, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin*, Fondacioni për Shërbime të Sipërmarrjes së të Rinjve
6. *Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore* (“Gazeta zyrtare e RMV”, nr. 10/2020)
7. *Kodi Zgjedhor* (Teksti i konsoliduar / versioni jozyrtar i përgatitur nga shërbimi ekspert i KSHZ-së në Shkurt 2020) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, Nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136 / 16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, 98/19 dhe 42/20); në dispozicion në: <https://www.sec.mk/izboren-zakonik/> dhe Ligji për Ndryshimet e Kodit Zgjedhor („Gazeta Zyrtare e RMV“ nr. 215/21)
8. *Strategjia Kombëtare për të Rinj (2016-2025)*, Agjencia për Rini dhe Sport (në dispozicion në <http://strategijazamladi.mk/node/3>)
9. *Udhëzues për Vëzhgimin dhe Nxitjen e Pjesëmarrjes së Pakicave Kombëtare në Proceset Zgjedhore*, OSBE/ODIHR, 2014 (në dispozicion në: <https://www.osce.org/odihr/elections/124067>)
10. *Udhëzues për vëzhgimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje*, OSBE/ODIHR, 2017 (në dispozicion në: <https://www.osce.org/odihr/elections/339571>)

11. *Manual për monitorimin e pjesëmarrjes së gruas në zgjedhje*, OSBE/ODIHR, 2004 (në dispozicion në: <https://www.osce.org/odihr/elections/13938>)
12. *Manual për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve për Zgjedhjet*, OSBE/ODIHR, 2018 (në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/0/385005.pdf>)
13. „Trego tënden!“ *Doracak i Kartës Evropiane të Rishikuar për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale*, Këshilli i Evropës, qershor 2015 (në dispozicion në <https://www.coe.int/en/web/youth/-/have-your-say-manual-in-albanian-and-macedonian>)
14. Alex Farrow, *SALTO Think Tank on Youth Participation: Closer to the edge of participation and activism*, Talinn, 2018
15. *Compendium of Good Practices for Advancing Women’s Political Participation in the OSCE Region*, OSCE/ODIHR 2016 (në dispozicion në: <https://www.osce.org/odihr/224206>)
16. EU-Council of Europe Youth Partnership, Symposium “*The future of young people’s political participation: questions, challenges and opportunities*”, 2019 (në dispozicion në: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/youth-partnership/symposium-2019>)
17. Forbrig J. (ed.), *Revisiting youth political participation – Challenges for research and democratic practice in Europe*, Council of Europe, 2005
18. *Gender Equality & Election Management Bodies: A Best Practices Guide, USAID and IFES, 2014* (në dispozicion në: https://www.ifes.org/sites/default/files/gender_equality_and_emb_best_practices_guide_final_2.pdf)
19. *Inclusive Electoral Processes: A Guide for Electoral Management Bodies on Promoting Gender Equality and Women’s Participation*, UNDP/UN Women, 2015 (në dispozicion në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2015/inclusive-electoral-processes-en.pdf?la=en&vs=633>)
20. *Youth Participation in Democratic Life*, London School of Economics, 2013